

LIGJ
Nr.9677, datë 13.1.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8410, DATË 30.9.1998 “PËR
RADION DHE TELEVISIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 8
Përbërja

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë të zgjedhur nga radhët e personaliteteve në fushat e politologjisë, drejtësisë, medias, sociologjisë apo shkencave të tjera humanitare, të cilat kanë lidhje ose ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi qëllimet e veprimtarisë radiotelevizive, siç përcaktohet në nenet 35 e 36 të këtij ligji.

KKRT-ja ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me këtë ligj nën mbikëqyrjen e Kuvendit.

Funksioni i Kryetarit dhe i Zëvendëskryetarit është me kohë të plotë dhe i papajtueshëm me çdo detyrë ose funksion tjetër publik e privat, me përjashtim të mësimdhënies.

Paga e Kryetarit, e Zëvendëskryetarit dhe masa e shpërblimit të 5 anëtarëve të tjerë të këtij këshilli caktohet në përputhje me ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të pavaruara të krijuara me ligj".

Neni 2

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar të KKRT-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozura nga subjektet përkatëse si më poshtë:

nga shoqatat dhe grupimet e mediave elektronike;

b) nga shoqatat e medias së shkruar;

c) nga profesorati dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

ç) nga profesorati i së drejtës, shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

d) nga subjektet parlamentare;

dh) nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikat publike.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Për përzgjedhjen e kandidaturave alternative për çdo vend anëtar të KKRT-së,

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e një numri që i korrespondon dy të tillave për çdo vend anëtar, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.

3. Në fjalinë e dytë të paragrafit të dytë të pikës 5 numri “3” zëvendësohet me numrin “5”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 17

Kuorumi dhe vendimmarrja

1. Mbledhjet e KKRT-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë jo më pak se 4 anëtarë, me përjashtim të rasteve kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Vendimet e KKRT-së, të marra sipas pikave 5 dhe 6 të nenit 7 dhe pikës 5 të nenit 9 të këtij ligji, quhen të miratuara kur për to votojnë pro jo më pak se 5.”.

Neni 4

Në nenin 88 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli Drejtues i RTSH-së përbëhet nga 11 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë pas një përzgjedhjeje në bazë të propozimeve të subjekteve përkatëse të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i propozon Kuvendit 2 kandidatura alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, pas një përzgjedhjeje mes të paktën 4 kandidaturave të propozuara nga subjektet përkatëse si më poshtë:

a) nga shoqatat e grupimet e mediave elektronike dhe shoqatat e medias së shkruar;

nga senatet e universiteteve publike;

c) nga profesori dhe shoqatat e inxhinierisë elektrike dhe elektronike;

ç) nga shoqatat e juristëve dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

d) nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve ose kërkimeve në politikën publike;

dh) nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë, institucionet publike të artit skenik dhe shoqatat e shkrimtarëve.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për përzgjedhjen e kandidaturave alternative për çdo vend anëtar të Këshillit Drejtues të RTSH-së, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik zbaton procedurën e mëposhtme:

Kandidaturat e administruara, në bazë të propozimeve të mësipërme, i nënshtrohen përjashtimit një nga një deri në mbetjen e një numri që i korrespondon dy të tillave për çdo vend anëtar, të cilat i propozohen seancës plenare. Procedura e përjashtimit zbatohet sipas radhës: një nga përfaqësuesit e shumicës parlamentare dhe një nga përfaqësuesit e opozitës.”.

4. Në pikën 6 fjalët “3 anëtarë” zëvendësohen me fjalët “5 anëtarë”.

Neni 5

Neni 95 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 95

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues të RTSH-së janë të vlefshme kur në to marrin pjesë shumica

e anëtarëve. Vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së merren me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me përjashtim të rasteve, kur kërkohet shumicë e cilësuar për marrjen e vendimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së, të marra sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 99 të këtij ligji, quhen të miratuara, kur për to votojnë pro jo më pak se 7 anëtarë.”.

Neni 6

Dispozitë kalimtare

Kuvendi brenda, 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, zgjedh anëtarët e rinj të KKRT-së dhe të Këshillit Drejtues të RTSH-së sipas këtij ligji.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.5193, datë 14.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu